

VENDIM
Nr.368, datë 1.4.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË KOMUNËS NOVOSELË TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Novoselë të qarkut të Korçës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Novoselë të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr.1235, datë 10.9.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Novoselë të qarkut të Korçës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Novoselë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

NUMRAT RENDORË TË PRONAVE NË LISTËN E INVENTARIT	FUSHA E PËRDORIMIT TË PRONËS	LLOJI I TRANSFERIMIT
249	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E PROGRAMEVE ADMINISTRATIVE.	NË PRONËSI
250-258	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E PROGRAMEVE ARSIMORE.	NË PRONËSI
259-266	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E VEPRIMTARIVE SOCIAL-KULTURORE E SPORTIVE.	NË PRONËSI
267-270	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E FUNKSIONEVE NË SHËNDETIN PUBLIK.	NË PRONËSI
271-273	INFRASTRUKTURË (SHESHE, LULISHTË DHE SHËRBIME PUBLIKE).	NË PRONËSI
274-290	VARREZA PUBLIKE	NË PRONËSI
292-294	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E FUNKSIONEVE NË ZHVILLIMIN EKONOMIK.	NË PRONËSI
295,296,298,300,301,302,304,305,306,308,310,311,313,315,317,319	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT (TOKA PRODUKTIVE).	NË PËRDORIM
297,299,303,307,309,312,314,316,318,320	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT (TOKA JOPRODUKTIVE DHE KANALE TË TRETA).	NË PRONËSI
321-341	INFRASTRUKTURË (RRUGË VENDORE)	NË PRONËSI
372-405	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE	NË PRONËSI
427-439	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E MBROJTJES CIVILE.	NË PRONËSI